



Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës,Drejtoria Komunale e Arsimit shpallë:

KONKURS

**PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË(10) NË
GJIMNAZIN „HAXHI ZEKA” DHE SHKOLLËN E MESME TEKNIKE
„MITHAT FRASHËRI” PËR VITIN SHKOLLOR 2015/2016**

ISTOG.16.06.2014.-Numri i protokolit 158.

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2015/16, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9^e të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes.

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2015/2016, bëhet më datën 18, 19 dhe 22 qershor 2015 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 23.6.2015.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 24.6.2015.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

- | | | |
|--|-------|---------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (25%) | 25 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test | (15%) | 15 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (60%) | 60 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 25 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\frac{\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)}}{4} \times 5 = 25$$

2. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 15 pikë (p.sh 3 lëndë të profilit të caktuar shumëzohet më mesataren e notave të kl. 6 – 9 të (5+5+5+5) = 20; 20 : 4 = 5)

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III)}}{3} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

Kur në profilin e caktuar kërkohen vetëm dy lëndë atëherë: 2 X 5 = 10 në këtë rast vlera e fituar shumëzohet me 1.5.

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II)}}{2} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

1. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- **Gjimnazi i shkencave natyrore** - Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji së paku duhet të jetë 4 (katër), ky kriter vlen edhe për të gjitha profilet e shkollës së mjekësisë. si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji)
- **Gjimnazi i shkencave shoqërore** - Mesatarja e lëndëve: histori, gjeografi, edukatë qytetare së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët histori dhe gjeografi)

p.sh për tri lëndë:
$$\frac{Kimi (3) + Biologji (4) + Fizikë (5)}{3} = \frac{3 + 4 + 5}{3} = \frac{12}{3} = 4$$

B. Përmbajtja e testit – numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

I. Shkencat natyrore:

- | | | |
|-------------|--------|--------------------|
| 1. Fizikë | 9 pikë | |
| 2. Kimi | 8 pikë | |
| 3. Biologji | 8 pikë | (Gjithsej 25 pikë) |

II. Shkencat shoqërore:

- | | |
|--------------|--------------------|
| 1. Gjeografi | 12 pikë |
| 2. Histori | 13 pikë |
| | (Gjithsej 25 pikë) |

2. Renditja e lëndëve me prioritet sipas drejtimeve të gjimnazeve:

I. Gjimnazi shkencat e natyrës:

- | | |
|-----------------------------------|----|
| 1. Shkencat e natyrës | 25 |
| 2. Matematikë dhe Informatikë | 25 |
| 3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze | 25 |
| 4. Shkencat shoqërore | 25 |

Totali = 60 pikë

$25 \times 1.2 = 30$ pikë

$25 \times 0.6 = 15$ pikë

$25 \times 0.4 = 10$ pikë

$25 \times 0.2 = 5$ pikë

Totali = 60 pikë

II. Gjimnazi shoqëror:

- | | |
|-----------------------------------|----|
| 1. Shkenca shoqërore | 25 |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze | 25 |
| 3. Matematikë dhe Informatikë | 25 |
| 4. Shkenca natyrore | 25 |

$25 \times 1.2 = 30$ pikë

$25 \times 0.6 = 15$ pikë

$25 \times 0.4 = 10$ pikë

$25 \times 0.2 = 5$ pikë

Totali = 60 pikë

3.Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në shkolla profesionale

I. Bujqësi

1. Shkencat natyrore 25 $25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkencat shoqërore 25 $25 \times 0.2 = 5$ pikë

Totali = 60 pikë

II. Makineri, Elektroteknikë, Ndërtimtari.

1. Matematikë dhe Informatikë 25 $25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Shkenca natyrore 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkenca shoqërore 25 $25 \times 0.2 = 5$ pikë

Totali = 60 pikë

III. Ekonomi

1. Matematikë dhe informatikë 25 $25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Shkenca shoqërore 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkencat natyrore 25 $25 \times 0.2 = 5$ pikë

Totali = 60 pikë

Të dhënat për drejtimet, paralelet dhe numrin e nxënësve për regjistrim:
Tabela-1-Gjimnazi „Haxhi Zeka”.

Emri i shkollës	Drejtimet	Planifikimi për regjistrim në vitin 2015-2016		
		Nr. i paraleleve	Nr.i nxënësve	
Haxhi Zeka	Shkenca natyrore	7		224
	Shkenca shoqërore	4		128

Tabela-2-SHMT-„Mithat Frashëri”.

Emri i shkollës	Lëmi i punës	Profilet	Planifikimi për regjistrim në vitin e ri shkollor 2015-2016	
			Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve
"Mithat Frasheri	Makineri	Operator prodhimi	1	32
		Metalpunues	1	28
		Automekanik	1	28
		Mekanik i makinave	1	32
		Instalues i ngrohjes	1	28
	Elektrotek.	Informatike	2	64
		Energjetike	1	32
		Instalues elektrik	1	28
	Ndertimtari	Arkitekture	1	28
	Ekonomi	Tregtar me pakice dhe shumice	1	28
	Bujqesi	Hortikulture	1	28

Tabela-3-SHMT-„Mithat Frashëri”Rudina Dubravë

Emri i shkollës	Lëmi i punës	Profilet	Planifikimi për regjistrim në vitin e ri shkollor 2015-2016	
			Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve
"Mithat Frasheri	Makineri	operator prodhimi	1	17
		saldator	1	17
		automekanik	1	17
		instalues i ngrohjes	1	17
	Bujqesi	fermer	1	17



Drejtori i DKA-së:
Agim Haxhiu